

Vepra të Doris Lessing të botuara nga Skanderbeg Books:

Fëmija i pestë, *roman*

Sërish dashuri, *roman*

Doris Lessing

Vera para errësirës

Roman

Përktheu nga origjinali anglisht:
Merita Meçe



Skanderbeg Books

Titulli i origjinalit: *The Summer Before The Dark*

Copyright © 1973 by Doris Lessing

Copyright © 2010 në gjuhën shqipe, Skanderbeg Books, Tiranë

Të drejta të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri në gjuhën shqipe, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e kudo ku flitet shqip, nuk mund të botohet pa lejen e Skanderbeg Books Tiranë

ISBN 978-99943-51-47-3

Skanderbeg Books

L. nr.4, Rr. "H.H.Dalliu", Pallati 184/9,

Tirana, Albania

Tel. 00355 4 2260945/2230721

E-mail: redaksia@skanderbegbooks.com

http: www.skanderbegbooks.com

Shtypur në shtypshkronjën Real-stamp, Tiranë

Në shtëpi

Një grua qëndronte e mbështetur mbi këmbën që e mbante një hap prapa, me krahë të kryqëzuar, duke pritur.

Po mendonte? Ajo nuk do të thoshte kështu. Ajo po përpiquej të kapte diçka, ose ta zbulonte, të tillë që mund ta shihte dhe ta përkufizonte; ajo kishte kohë që po “provonte” idetë si shumë fustane të nxjerra nga varësja. Ajo po i lëshonte fjalët e frazat po aq zvarrë, sa edhe ninullat që dalin pa u ndjerë nga gjuha e saj: shumë shabllone. *Ah po, dashuria e parë!... Duke u rritur bëhet e dhimbshme!... Fëmija im i parë, e kupton... por unë isha e dashuruar!... Martesa është një kompromis... Unë nuk jam aq e re siç kam qenë dikur.* Sigurisht, zgjedhja e njëres prej këtyre frazave të rrënjosura nga koha, në vend të tjetrës, rrallë kishte të bënte me ndjenjën personale, por më shumë me gjendjen tënde shoqërore ose njerëz me të cilët ti je në një ngjarje. Ti duhet të nxjerrësh konkluzione për diçka mbi ndjenjat e vërteta të një njeriu, me një buzëqeshje që ti nuk e di se e ke në fytyrën tënde, nga mënyra se si hidhërimi tendos muskujt e anës së gojës ose mënyra se si ajri, më pas, del nga mushkëritë: *Unë nuk do të doja të isha fëmijë përsëri!* Të tillë fuqi kanë këto fraza, të gjitha të lëshuara për përdorim siç mund të ndodhi veçanërisht në një fushatë reklamash të frytshme, që ka të ngjarë që shumë njerëz të vazhdojnë të përsërisin, *Rinia është pjesa më e mirë e jetës, ose Dashuria është gjithë jeta e gruas,* derisa ata, në të vërtetë, të shihnin veten në një pasqyrë ndërsa thoshin diçka të tillë, ose të jenë mjaft të shpejtë për të kapur reagimin mbi fytyrën e ndonjë miku.

Një grua qëndronte mbështetur tek shkallarja e pasme,

me krahë të kryqëzuar, duke pritur për ibrikun që të ziente.

Kishte pasur ndërprerje të energjisë elektrike në pjesën më të madhe të ditës për shkak të grevës. Timi, djali i saj më i vogël, dhe Eilina, e bija, kishin shkuar me makinë herët jashtë zonës ku jetonin, kishin mbledhur drutë e rrëzuar përdhe në pyllin Eping, e – duke shijuar çdo minutë – kishin bërë një zjarr mbi zhavorrin e rrugicës dhe kishin vendosur mbi të një këmbalec me tri këmbë të bërë prej një hekurishteje të gjetur në fund të garazhit. Zjarri, gatimi me të, kujdesja për të, shaka të rreth tij, kishin qenë frymëzimi i kënaqësisë së familjes gjatë gjithë ditës. Sidoqoftë, gruaja e kishte parë atë si diçka acaruese. Ibrikut iu desh njëzet minuta që të fillonte të fërshëllente: ajo nuk mbante mend të kishte dëgjuar fërshëllimën e ibrikut për vite. Korenti e ktheu ujin në çast nga gjendja e qetë në gjendje të trazuar dhe fërshëllima u kapërcye krejtësisht...

Ndoshta ajo kishte qenë indiferente? Ndoshta të dy, Timi dhe Eilina – që, në fund të fundit, ishin rritur, ishin bërë nëntëmbëdhjetë dhe njëzet e dy vjeç – nuk i kishin gëzuar aq shumë sa duhej fantazitë e vogla të ditës; ata kishin pretenduar se nuk lidheshin me emocionin shoqëror? Në fakt, sjellja e tyre kishte qenë e barazvlershme me atë të një prej thënieve të vjetra, një zakon që njerëzit nuk dinë se si ta lënë për hir të së vërtetës – çfarëdo që të ishte ajo?

Pikërisht si ajo vetë.

E vërteta ishte se ajo ishte e ndërgjegjshme se po vihej gjithnjë e më shumë në siklet, jo vetëm për gjërat që thoshte, e shumë të tjera që i mendonte, që kishin qenë si të hequra prej një varëseje dhe ishin përdorur, por ajo që ndjente në të vërtetë ishte diçka tjetër.

Gruaja lëshoi krahët e mbledhur, bëri disa hapa drejt një pajisjeje të vockël absurde në mes të rrugës së shtruar me zhavorr, hodhi disa degëza të tjera nën

ibrikun që tundej nga pak prej telit të përkulur të këmbalecit me tre këmbë dhe mbajti vesh: a po ndryshonte sadopak melodija e fërshëllimës së ibrikut? Ajo mendonte se po ndryshonte. Nëse nesër do të kishte ndërprerje të energjisë, siç ishte paralajmëruar, do të ishte e udhës të merrnin një sobë si ato që merren për fushim ose diçka e tillë: kjo ide ishte shumë e mirë, por nëse binte shi... Thuhej që greva do të vazhdonte për disa kohë. Kjo prerje e radhës e energjisë elektrike dukej se kishte ndodhur shumë shpejt pas asaj të fundit? Dukej sikur krizat mbi energjinë – ngrohjen, dritën, karburantin – ishin lidhur për t'u bërë më të shpeshta dhe do të ishte me vend për të marrë masa? Ndoshta Timi dhe Eilina kishin të drejtë: një barrë dru mund të ishte një ide e mirë.

Gruaja qëndroi përsëri në hapin e saj të pasmë, mbështetur pas murit, dhe me krahët e kryqëzuar.

Kishte ngjarje të përgjithshme ose të përbashkëta – luftëra, greva, përmytje, tërmete; ato që shihen si veprime të zotit. Kudo ekzistonte mendimi, i arsyeshëm ose jo, që këto dukuri, dikur të forta dhe të rralla (ose kishin qenë ndonjëherë, a ishte ajo thjesht një kujtim i rremë?), po zhvendoseshin në plan të parë të eksperiencës së çdo njeriu sikur një atmosferë që dikur kishte qenë mjedisi i një ylli të përmbysur dhe të largët kishte zgjedhur të gllabëronte planetin tonë të mjerë. Kur mendoje rreth tyre, përvojat rraskapitëse, ishin për shumë e shumë njerëz: pushtim, luftë, luftë civile, epidemi, zi buke, përmytje, tërmet, helmimi i tokës, ushqimit dhe ajrit. Për këto, qëndrime të caktuara ishin shabllone. Asgjë nuk shkon përtej: *Ne duhet të bëjmë diçka për të, ose oh fatkeqësi, të shkretën!* Nuk ka kaq shumë nuanca të mundshme për: *E gjithë familja ime vdiq në kamp përqendrimi, ose Katër prej fëmijëve të mi kanë vdekur nga uria, ose Motra ime dhe fëmija i saj u vranë nga ushtarët.* Por dukej sikur stereotipet për ngjarjet publike ishin më të sinqerta se ato të ngjarjeve private? *Oh fatkeqësi, të shkretën!* A ka lidhje me të?

Ajo vuri re që ibriku ishte më i qetë dhe zgjati krahun në dhomën pas saj në kuzhinë, për të marrë një xhezve kineze shumë të madhe që tashmë kishte kafe brenda. Ajo qëndroi me të në dorë, pranë zjarrit, duke pritur për valën që të ngrinte vullshëm kapakun e ibrikut.

Nuk kishte kuptim të shihje gjërat nga pikëpamja e momenteve kulmore dhe krizave: tek e fundit, ngjarjet personale, si ato publike, ishin çështje afatgjata. Ato të formuara gradualisht... Më e pakta është për disa muaj, por zakonisht do vite, që një person të thotë: *O zot, e gjithë jeta ime ka ndryshuar* – duke folur për një zemërim të dashurisë, ose urrejtjes, një martesë, një periudhë prove në punë. *Jeta ime ka ndryshuar sepse unë kam ndryshuar*.

Vala ishte ngritur mbi kapakun e ibrikut dhe po derdhej rrëke.

Ajo kapi dorezën e ibrikut me leckë, dhe hodhi mbi kafën ujin që lëshonte zhurmë. E vuri ibrikun mbi njërën anë të zjarrit, por jo mbi lëndinë që, ndryshe, do të kishte një njollë të verdhë të rrumbullakët mbi të, dhe largoi disa drunj gjysmë të djegur nga vatra e zjarrit; nëse binte shi, ajo duhet të kujtohej që t'i mbulonte ata dhe drutë e padjegur. Ajo nuk ishte e gjithanshme që të dinte se si të ndizte zjarrin me dru të lagur.

E mori ibrikun me njërën dorë, xhezven me dorën tjetër e u largua nga oborri prapa shtëpisë për në kuzhinë.

Unë kam qenë në furrë, jam bluar imët në mullinj... Këto fjalë nuk u thanë apo ndjenë pa njëfarë kënaqësie. Sigurisht që ishte një fakt i jashtëzakonshëm? Mendimi që diçka ishte arritur ishte i jashtëzakonshëm?, por, në fund të fundit, ai ishte ndjerë aq shumë nga njerëzit që ishin (relativisht të vegjël) në numër, krahasuar me banorët e botës, që ishin dakord me idenë se jeta nuk është më e rëndësishme se sa ajo e një brumbulli, si edhe nga ata që kishin idenë e vjetër që ka rëndësi ajo që ne bëjmë sepse ne jemi të rëndësishëm para syve të zotit. Ose të zotave. Por pse dikush duhet të merakoset që ai ose ajo, ka

ndryshuar, ka mësuar, është pjekur, rritur, nëse ai ose ajo është një brumbull? Ose madje një flutur? Sepse nuk ka fare dyshim që mendimi ekziston, dhe është ndoshta mendimi më i thellë që ne kemi, që ajo që ka rëndësi më shumë është që ne mësojmë duke jetuar. Ky mendim duhet të lidhet me një zakon, një mbeturinë më të hershme, nga kohët më primitive? Tek vetë rëndësia e brumbullit? Sepse nuk kishte dyshim për të që ishte atje, që “Zoti” e kishte dëbuar, deklaruar të vdekur ose jo. Kujt mendohet se mund t’i japë shpjegime brumbulli?

Ne jemi ata që mësojmë.

Shpesh ajo merr një kohë të gjatë dhe të vështirë.

Fatkeqësisht nuk ka dyshim që shumë kohë, shumë merak shkuan për të mësuar shumë pak...

Vërtet ajo ndjente kështu? Po.

Sepse ishte e dëshpëruar? A ishte e dëshpëruar? Ndoshta. Ajo ishte dikush, ajo po ndjente diçka shumë fuqishëm që nuk do të vinte gishtin e saj mbi...

Gruaja e vuri xhezven mbi një tabaka që tashmë ishte me filxhanë dhe pjata, lugë, sheqer, kullësën dhe e ngriti atë: para se të dilte nga dhoma me të ajo ktheu kokën pas nga tavolina mbi të cilën ishin bërë piring pjatat e palara të drekës. Kishte edhe pjata nga ato të mëngjesit. Ndoshta ajo mund t’i thoshte Timit ta ndizte zjarrin përsëri, të ziente prapë ibrikun, e pastaj kur uji të ishte gati ai do ta thërriste atë për të larë enët? Jo, më mirë jo në atë gjendje humori që ishte, do të ishte më mirë që ajo t’i bënte vetë të gjitha gjërat më vonë.

Gruaja doli nga dera anësore mbi një lëndinë që kishte nevojë për krasitje dhe ishte bërë me pika joshëse prej luleshqerrave drejt një peme në oborrin e saj. Kjo grua ishte Kati Braun; për të qenë të saktë Katerina Braun ose zonja e Majkëll Braun. Ajo e mbante tabakanë me kujdes, dhe po mendonte për larjen e enëve ndërsa vazhdonte me inventarin e jetës së saj private, bërjen e llogarive... Ajo dëshironte që të mbaronte me shpejtësi pavarësisht

nga stadi i jetës në të cilin ndodhej sepse i dukej i pafund. Nëse jeta duhet të shihej në terma të momenteve kulmore ose majave, atëherë asgjë nuk “i kishte ndodhur” asaj për një kohë të gjatë; e ajo mund të priste me padurim asgjë më shumë se një pakësim të punëve të shtëpisë kur të plakej.

Ndonjëherë, po të jesh me fat, një proces ose një fazë përqendrohet. Katit do t’i dilte që ajo verë do të ishte një periudhë e tillë e përqendruar, e lartësuar, e shkurtuar.

Çfarë do të kalonte ajo? Thjesht, asgjë më shumë se do të plakej: plakja, pasardhësja dhe përsëritësja e stadi të rritjes. Sigurisht që ajo i ndodh çdo njeriu – *ah edhe mua, koha fluturon!... Para se ta kuptosh, jeta ka kaluar... Pjekuria është gjithçka*. E kështu me radhë. Por në rastin e Katit nuk do të jetë aspak një proces që zgjat një dekadë apo dy, zor se vihet re ndërsa vazhdonte përveç përpjekjeve të dëshpëruara për të mbajtur përmbytjen – duke lyer flokët, duke kontrolluar peshën e trupit, duke ndjekur modën me kujdes kështu që ajo ishte e veshur mirë, por jo e sajuar. Pothuajse për të gjithë pleqtë, po të mos ishin goditur nga fatkeqësitë, rrëshqitja e tokës nën këmbë, përmbytja e qytetit nga uji, bombat që shkatërrojnë fëmijët dhe bëjnë zemrat e tyre ta shohin jetën me indiferencë – plakja është çështje vitesh. Ti je i ri, më pas kalon në moshën e mesme, por është e vështirë të thuash momentin e kalimit nga një fazë në tjetrën. Pastaj ti je i plakur, por ti zor se e di se kur ka ndodhur. Ndryshimet janë kryer – ah po, ato jetiket – në qëndrimet e tua ndaj atyre që të rrethojnë, por ti mezi i kupton ata sepse janë shtrirë me ngadalë. Është diçka e tillë për shumicën e njerëzve: *Kam frikë se unë nuk jam aq e re sa kam qenë dikur*. Por Kati Braun do ta kapërcente gjithçka brenda pak muajsh. Sepse – kur gjithçka dukej shumë personale, që kishte të bënte me të, me durimin e saj, humorin e mirë, kohën e saj – në të vërtetë do të ishin presionet e tjetrit, e njerëzve, që do të insistonin në jetën e saj të ngushtë,

e do të bënin që ajo të provonte rastin e ngutshëm? Sidoqoftë mund të ndodhë, sepse ngjarjet e verës nuk do të modeloheshin përmes ndonjë virtyti apo aftësie të saj.

Me kohë kur gjithçka të kishte mbaruar, ajo sigurisht që nuk do të kishte zgjedhur ta kishte atë ndryshe: ajo nuk do ta kishte zgjedhur atë për vete para kohe sepse ajo nuk kishte përvojë për të zgjedhur ose imagjinatë. Jo, ajo nuk do të *donte* atë që do të ndodhte, megjithëse ajo qëndronte në këmbë poshtë pemës së saj, me tabakanë në duar, duke menduar: ajo mendon pa pushim! Kjo është ajo që nuk shkon: duhet të jetë diçka që unë mund ta shoh tani, diçka që mund ta kuptoj *tani*, ndonjë lloj veprimi që duhet ta zgjedh...

Të zgjedh? E kur unë kam zgjedhur ndonjëherë? A kam zgjedhur ndonjëherë?

Një grua, siç mund të kishte bërë kurdoherë gjatë disa qindra viteve më parë, qëndronte në këmbë poshtë pemës duke mbajtur një tabaka të mbushur. Kati e vendosi tabakanë mbi tavolinën e oborrit të bërë prej një materiali të shpikur dekadën e fundit. Tavolina dukej si prej hekuri, ishte kaq e lehtë sa mund të ngrihej me dy gishta, ishte e ekuilibruar kështu që nuk ishte me rrezik po të vendosej ndonjë peshë në njërën anë të saj.

Ajo nuk e konsideronte atë tavolinë si një zgjedhje; ishte zgjedhur për të, si lënda plastike e gotave që duke-shin si prej porcelani.

Ajo u kthye në mes të lëndinës, dhe, para se të merrte frymë për të thirrur tek dritaret e sipërme të shtëpisë, e dinte se çfarë do të shihte kur i shoqi të dilte për t'i thënë: "Po vuj!"

Një grua me fustan të bardhë, këpucë të bardha, shall ngjyrë trëndafili hedhur rreth qafës qëndronte në këmbë mbi bar.

Tani ishte pjesa e zgjedhur, e vetëdijshme, e bërë me qëllim: pamja e saj e jashtme ishte një zgjedhje, gjithë takt, sepse ishte e përshtatshme për këtë skaj të klasës

së mesme dhe pozitën e saj në të si gruaja e burrit të saj. Dhe, sigurisht, si nëna e fëmijëve të saj.

Fustani kishte një etiketë metalike me shënimin “Jolie Madame” dhe ishte i hijshëm, pa shumë salltanete. Ajo kishte veshur këpucë dhe çorape. Flokët e saj – e tani ne arrijmë në pikën ku shumica e energjisë ishte përdorur për zgjedhjen – ishin bërë me krela të mëdha, të buta rreth fytyrës ku pak quka kishin mbetur në pjesën që lidh anën e hundës me pjesën e sipërme të faqeve. I shoqi i saj gjithmonë thoshte se i pëlqente ato. Flokët ishin të kuqërremtë – jo aq shumë të ekzagjeruar. Ajo ishte një grua e fortë, e shëndetshme, e bukur.

Kati qëndronte në këmbë mbi bar, me sy të lyer, dhe thirri: “Majkëll, Majkëll! Kafeja!”

Një fytyrë e paqartë nga prapa xhamave që vezullonin nga drita e diellit bërtiti: “Po vuj!”

Një grua e veshur si duhet për një pasdite në familje u kthye në këmbë përmes lëndinës, por me kujdes kështu që bari nuk linte shenja mbi këpucët e saj. Zgjedhja e saj do të ketë qenë të ecte këmbëzbathur, të hiqte çorapet e të vishte diçka si xherabie, sari ose një copë katërkëndëshe e mbështjellë rreth trupit si fund – diçka e këtij lloji – me flokët që binin tek supet.

Ajo nuk e kishte lënë veten të shkëlqente sepse kishte vënë re që në fillim, në adoleshencën e fëmijëve, se sa shumë ata nuk pëlqenin që ajo ta shprehte lirshëm tipin e saj. Meri Finçli, e veshur ndryshe, sikurse ajo do të kishte bërë po të mos kishte fëmijë dhe të ishte e pamartuar: fëmijët e saj e urrenin atë dhe e tregonin këtë me qindra mënyra.

Ndonëse Kati ishte gjithmonë dakord me Merin kur ajo thoshte: “Pse ne duhet të ulim veten tonë, ndërsa fëmijët nuk duhet të jenë tiranë” – në fakt ajo gjithmonë e ka bërë, gjithmonë e kishte ulur veten. Por ajo nuk mund të kuptonte që fëmijët e saj ishin më të mirë se të Meri Finçlit në këtë drejtim.

Kati u ul poshtë pemës në një mënyrë të tillë që trupin e kishte në hije, dhe këmbët e shtrira në diell sikur të ishin pa çorape. Ajo po këqyrte shtëpinë e saj të madhe katrore me oborrin e madh. E bënte këtë si dikush që do t'i thoshte mirëpafshim, por kjo ishte vetëm ngaqë ajo dhe i shoqi kohët e fundit kishin thënë që tani që fëmijët të gjithë po rriteshin, ishte koha të fillonin të mendonin për të gjetur për veten një diçka më të vogël? Një apartament? Ata mund të blinin një shtëpi në zonë dhe ta ndanin me miq – ndoshta me Finçlët.

Kati mendonte shpesh për këtë, por si diçka që kishte të bënte me vitet që do të vinin.

Ndërkohë ishte Maj, vera angleze me hope dhe jo e qendrueshme, e, duke qenë largpamëse për verën, kishte një boshllëk në jetën e familjes, atij organizmi që pulsonte qetësisht në Londrën e jugut: për të qenë të saktë, në Blekheath. Nga kjo periferi çdo vit, gjithnjë e më shumë, ndërsa fëmijët bëheshin të rritur, ishte sikur ajo njësi, krijesë, ose organizëm, shpërthente për nga jashtë, duke u shpërndarë gjithnjë e më larg nëpër glob. Ishte si një nxjerrje vjetore e frymës që fillonte në pranverën e vonë me një thithje në shtator.

Vitin e kaluar Majkëlli, që ishte neurolog me emër të mirë, e kishte shkuar në korrik në Amerikë për një konferencë, kishte shfrytëzuar rastin të punonte për tre muaj në një spital të Bostonit, e ishte kthyer vetëm në Tetor. Kati kishte shkuar me të shoqin në konferencë, ishte kthyer për arsye familjare, kishte shkuar përsëri tek i shoqi në shtator – lëvizjet e saj gjithmonë kombinoheshin me ato të fëmijëve. Ata shkonin e vinin, e nga pjesë të ndryshme të Evropës, gjithë verën.

Sivjet Majkëlli do të shkonte në të njëjtin spital në Boston për katër muaj, duke u këmbyer me një koleg. Djali më i madh, Stefani, që tani ishte njëzet e tre vjeç dhe në vitin e fundit të universitetit, do të shkonte në një udhëtim katër mujor nëpër Marok dhe Algjeri me sho-

kët. Eilina, njëzet e dy vjeçe, kishte shoqëruar të atin për të vizituar shokët gjatë një udhëtimiti në formë fushimi të bërë parvjet në Spanjë. Djali i dytë, Xhejmsi, ishte ftuar në një “gërmim” arkeologjik në Sudan, para se të fillonte universitetin po atë vjeshtë. Ndërsa për vete, ajo kishte vendosur për të mos shkuar përsëri në Amerikë. Sepse, në njëfarë mase, ajo nuk donte të sforconte të bijën, meqë e dinte se ajo do të sforcohej. Gjithashtu, do të ishte shumë shtrenjtë nëse tre njerëz largoheshin nga shtëpia. Ishte edhe puna nëse ajo do të sforconte tipin e të shoqit... Duke shkuar me këtë mendim, kishte buzëqeshjen e duhur, pothuajse një ngërdheshje, e përshtatshme ndoshta për fjalët *Duhet të jepet dhe merret në çdo martesë*; ajo e dinte që nuk donte ta kontrollonte këtë fushë më nga afër.

Edhe për diçka tjetër që Timi, megjithëse tani ishte nëntëmbëdhjetë vjeç, dhe shumë i inkurajuar nga kushdo për të qenë i pavarur, nuk kishte plane për të udhëtuar gjëkund. Ai ishte, ai gjithmonë kishte qenë, “i vështiri”, ose problematiku. Shtëpia në Londrën e jugut do të qëndronte hapur për të. Ajo, e ëma, do ta drejtonte atë. Për Katin, muajt që do të vinin, ishin përpara siç kishin qenë për shumë behare të kaluar. Ajo do të ishte një bazë për pjesëtarët e familjes që vinin në shtëpi nga universiteti, ose duke u ndaluar për një ditë ose një javë gjatë rrugës së tyre nga diku tjetër; ajo do të kujdesej në shtëpi për ta, për shokët e tyre, për shokët e shokëve të tyre. Ajo do të ishte e gatshme, në dispozicion të çdo njeriu.

Ajo mezi po e priste atë çast: jo vetëm për njerëzit, por për drejtimin e shtëpisë që ata të ishin të ndërjegjshëm për rëndësinë e saj; ajo priste me padurim kopshtarin e zotë të verës. Kur ata – Kati dhe Majkëlli – do ta linin këtë shtëpi si një çift që largohet nga një skenë aktive, nuk do të ishte shtëpia ajo për të cilën do t’i merrte malli, por oborri që ishte aq i këndshëm sa ç’mund të jetë një oborr anglez pas nja njëzet vitesh përkushtimi. Dukej



ShtepiaeLibrit.com

Libraria ime...

Si mund të porosisni libra nga ShtepiaeLibrit.com ?

Përshëndetje mik i librit!

Prej 3 vitesh, **ShtepiaeLibrit.com** shërben si një **librari virtuale** ku ju mund të **informoheni** dhe të **porosisni** libra direkt nga interneti.

Ne të specializuar në **promovimin**, **tregtimin** dhe **dërgimin** e librave shqip.

Ne dërgojmë porosi **në çdo vend të botës**, prandaj për të porositur libra mjafton të na jepni një **adresë të saktë postimi** dhe të **konfirmoni pagesën tuaj**. Më pas librat do t'ju vijnë me postë në adresën e porositur nga ju.



Aktualisht, **mënyrat kryesore të pagesës** për porositjen e librave janë këto:

1. duke paguar me **kartat e internetit: Visa, MasterCard, American Express** ose **Discover**
2. duke paguar me **PayPal.com** drejt adresës tonë: **sales@shtepiaelibrit.com**
3. duke i transferuar fondet në llogarinë tonë bankare në **Shqipëri** (ose në **Kosovë**)
4. duke i dërguar fondet nëpërmjet shërbimeve **Western Union, MoneyGram**, etj.

Pagesat mund të kryhen në **Euro, USD, Paund** dhe sigurisht **Lekë**. Porositë me **kartat e internetit** dhe me **PayPal** mund të kryen direkt nga faqja jonë. Për **transfertat bankare** apo **dërgesat** me Western Union, MoneyGram, etj, ju lutem na kontaktoni paraprakisht me email që t'ju dërgojmë informacionet që do t'ju nevojiten.



Për klientët tanë nga **Shqipëria**, ne ofrojmë mundësinë e blerjes së librave **në lekë pranë librarisë tonë në Tiranë** (afër qendrës) ose **me pagesë bankare** brenda Shqipërisë. Postimi i librave brenda Shqipërisë bëhet **FALAS** nëse porosisni më shumë se një libër. Porositë brenda Tiranës mund t'i sjellim edhe dorazi.



Për klientët tanë nga **Kosova**, përveç pagesave nëpërmjet internetit ne ofrojmë edhe mundësinë e pagesës **me transfertë bankare në Euro**. Pagesat kryhen pranë **ProCredit Bank në Kosovë**. Librat ju vijnë me postë për 1 javë nga dita e pagesës.

Mirëpresim çdo pyetje apo kërkesë tjetër që mund të keni.

--

Elvisi & Gjergji

Administratorë

E-mail: admin@shtepiaelibrit.com **Tel.** +355 4 450 3262 **Mobile:** +355 68 60 52 510

Website: <http://www.ShtepiaeLibrit.com>

Adresa jonë: Libraria "Shtëpia e Librit"

Rruga e Barrikadave, Galeria Nasional (ish-Kinema 17 Nëntori), Kati I, Tirana, Albania.